

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AKTIN E GJENEVËS TË MARRËVESHJES SË LISBONËS “PËR EMËRTIMET E ORIGJINËS DHE TREGUESIT GJEOGRAFIKË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Akti i Gjenevës mundëson regjistrimin ndërkombëtar të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës dhe lejon hyrjen në marrëveshjen e Lisbonës të organizatave ndërqeveritare.

Ky akt zhvillon më shumë kuadrin ligjor të sistemit të Lisbonës, një sistem që ndihmon në promovimin global të shumë produkteve si për shembull Scotch Whisky, çaj Darjeeling, kafen e Kolumbisë, verëra, veshje, artikuj qeramike, qelqi etj.

Aplikantët, që kanë siguruar mbrojtje në Shqipëri mbi një emërtim origjine apo tregues gjeografik, do të kenë mundësi që përmes një aplikimi të vetëm të mund të sigurojnë mbrojtje ndërkombëtare në të gjitha vendet anëtare të këtij akti.

Nënshkrimi i këtij akti do të ishte në interesin e mbajtësve të të drejtave mbi emërtimet e origjinës, të cilët me anë të një aplikimi të vetëm shkurtojnë kohë dhe kosto për mbrojtje në vendet e tjera.

Këto kushte favorizuese vlejné, gjithashtu, edhe për subjektet e huaja, të cilët duke e pasur emërtimin e origjinës të mbrojtur në Shqipëri, gjenden në një klimë më të sigurt të ushtrimit të biznesit të tyre dhe do të mund të pasurojnë tregun vendas me produkte me karakteristika unike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji i hartuar nuk është planifikuar në programin analitik të akteve dhe dokumente të tjera politike për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Sipas nenit 176, të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës që përdoren në tregti për të treguar origjinën gjeografike të produkteve, quhen emrat që identifikojnë produkte që e kanë origjinën në një vend specifik, rajon apo shtet, cilësitë,

reputacioni ose karakteristikat e tjera të të cilëve i atribuohen një mjedisi gjeografik të veçantë dhe një apo të gjithë hapat për prodhimin e të cilëve realizohen në zonën e përcaktuar gjeografike.

Aktualisht, në DPPI janë regjistruar 11 tregues gjeografikë dhe/ose emërtime origjine, me prejardhje nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, të tillë si keci i Hasit, boronica e bjeshkëve kuksiane dhe të Tropojës, gështenja dhe mjalti i gështenjës së Malësisë së Madhe, gështenja dhe mjalti i gështenjës së Tropojës, jufka dibrane, molla dibrane etj.

Të tilla produkte paraqesin rëndësi të veçantë për Shqipërinë, pasi regjistrimi kombëtar e më tej ai ndërkombëtar ndikon në rritjen e vlerës së këtyre produkteve tradicionale, në gjallërimin e zonave rurale, në ruajtjen e biodiversitetit, të trashëgimisë kulturore e gastronomike dhe ofron mundësinë e njohjes në tregjet e huaja të produkteve karakteristike shqiptare.

Përparësitë që sjell aderimi në këtë akt janë, si më poshtë:

- i. Akti Gjenevës bën shumë ndryshime dhe përmirësime në modernizimin e sistemit të regjistrimit të TGJ dhe EO.
- ii. Siguron të drejta që kombinojnë elementet e mbrojtjes së markave të mirënjohura dhe mbrojtjes së treguesve gjeografikë.
- iii. Vendet anëtare sigurojnë mjete ligjore për të parandaluar një përdorim të paautorizuar të treguesve gjeografikë në tre situata:
 - Mallrat që janë të njëjta me ato për të cilat është aplikuar për TGJ
 - Ndonjë praktikë që mashtron konsumatorët në lidhje me origjinën e vërtetë apo natyrën e mallrave (përfshirë imitimin e TGJ apo EO).
 - Mallrat apo shërbimet që nëpërmjet përdorimit lejojnë të përdoret reputacioni i TGJ apo EO.
- iv. Niveli i lartë i mbrojtjes që siguron marrëveshja e TRIPS për verërat dhe pijet alkoolike është afër standardit të marrëveshjes së Lisbonës të vitit 1958 dhe ndoshta edhe më shumë tani me aktin e Gjenevës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në përputhje të plotë me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Aderimi i Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë nuk synon përafrimin me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Konferenca diplomatike e mbajtur në Gjenevë më 11-21 maj 2015, miratoi aktin e Gjenevës së marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë.

Akti ka 34 nene që në mënyrë të përmbledhur përmbajnë përkufizime, procedurën për mbrojtjen ndërkombëtare, rastet e refuzimit, detaje për çfarë sigurohet mbrojtja dhe dispozita administrative.

Procedura e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar është njësoj si ajo e marrëveshjes së Lisbonës.

Regjistrimi ndërkombëtar i emërtimeve të origjinës bëhet nga Zyra Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale (WIPO) në Gjenevë, me kërkesë të autoritetit kompetent të shtetit kontraktues.

Kjo zyrë mban Regjistrin Ndërkombëtar të Emërtimeve të Origjinës dhe njofton formalisht shtetet e tjera kontraktuese për regjistrimin. Gjithashtu, zyra i publikon ato në buletin zyrtar të sistemit të Lisbonës.

Një shtet kontraktues mund të deklarojë, brenda një viti nga marrja e njoftimit për regjistrim, që nuk mund të sigurojë mbrojtjen e emërtimeve të origjinës në territorin e tij, duke dërguar një deklaratë refuzimi bashkë me bazat përkatëse të refuzimit.

Shtetet kontraktuese do të jenë anëtare të së njëjtës asamble si shtetet anëtare të Marrëveshjes së Lisbonës, edhe nëse janë apo jo anëtare të kësaj marrëveshjeje.

Çdo shtet kontraktues do të përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga ekspertë apo këshilltarë. Çdo delegacion përballon vetë shpenzimet përkatëse.

Asambleja do të merret me të gjitha çështjet që lidhen me zhvillimin e Unionit Special dhe zbatimin e këtij akti, do të amendojë rregulloret, do të miratojë buxhetin dyvjeçar të Unionit etj. (neni 22 i Aktit).

Aktualisht, janë 15 shtetet anëtare që e kanë firmosur aktin, Bosnja dhe Hercegovina, Burkina Faso, Kongo, Kosta Rika, Franca, Gaboni, Hungaria, Italia, Mali, Nikaragua, Peru, Portugalia, Republika e Moldavisë, Rumania, Togo.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe hartimin e këtij projektligji është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, si institucion publik jobuxhetor që regjistron, administron dhe promovon objektet e pronësisë industriale dhe

funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe hartimin e këtij projektligji është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, si institucion publik jobuxhetor që regjistron, administron dhe promovon objektet e pronësisë industriale dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Projektligji është konsultuar dhe bashkërenduar me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Buxheti për këtë akt (i përfshirë në sistemin e Lisbonës) miratohet nga Zyra Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe për dyvjeçarin 2018-2019 nuk parashikon të ardhura për vendet anëtare.

Gjatë dyvjeçarit të mëparshëm 2016-2017, sistemi i Lisbonës (që përfshin marrëveshjen e Lisbonës dhe aktin e Gjenevës) ka gjeneruar një deficit të ardhurash, deficit i cili është eliminuar kryesisht nëpërmjet kontributeve të vendeve anëtare dhe një huaje të marrë nga rezervat e unioneve të tjera të WIPO-s që bazohen në kontributet e shteteve anëtare.

Kontributi që DPPI-ja duhet të paguajë nëse aderon në këtë akt varet nga një sërë faktorësh. Konkretisht, do të merret parasysh shuma e deficitit të parashikuar gjatë dyvjeçarit, nëse ka, numri i vendeve anëtare në marrëveshje, klasa e kontributeve së cilës i përket Shqipëria, numri i regjistrimeve ndërkombëtare që kanë vendet nën aktin e Gjenevës (në ndryshim nga marrëveshja e Lisbonës) si edhe mënyra se si vendet anëtare të Unionit të Lisbonës vendosin të përdorin kontributet.

Në komunikimin që Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka pasur me WIPO-n, është informuar se Mali i Zi, i cili gjendet në të njëjtat kushte dhe në të njëjtën klasë kontributesh me Shqipërinë, i është caktuar për dyvjeçarin 2016/2017 detyrimi prej rreth 3.350 frangash zvicerane për aktin e Gjenevës (për dy regjistrime).

Në rast nënshkrimi të këtij akti, Shqipëria nuk preket nga asnjë deficit i krijuar para anëtarësimit por do të paguajë detyrimet që rrjedhin nga fakti që ky sistem rezulton ende i paqëndrueshëm financiarisht.

KËSHILLI I MINISTRAVE